



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE SHKODER

Adresa: L. QemalStafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 dhe +22 21 21 22

Nr. Rregj.Them.61/1292

Dt. Rregj. 08.09.2014

Nr. Vendimi 432

Dt. Vendimi 26.05.2015

V E N D I M

”Ne emer te Republikes”

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Shkoder, e perbere nga:

Tonin Sterkaj – Gjyqtar

dhe asistuar prej sekretares Erona Laçe, sot më datë 26.05.2014, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative me Nr.Regj.Them. 61/1292, me palë:

Padites: “Kampion sh.p.k”, me seli ne adrese: “Zona Industriale inxhinier Gjovalin Gjadri” Shkoder perfaqesuar nga administrator Gezim Bala, mbrojtur ne gjykim nga avokate Valbona Pecaj.

Te paditur: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder, perfaqesuar ne gjykim nga juriste Sirjana Bakushi, e pranishme ne seance gjyqesore.

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve Tirane, perfaqesuar ne gjykim nga juriste Sirjana Bakushi, e pranishme ne seance gjyqesore.

Objekti: Shfuqizimin e aktit administrativ “Njoftim vlersimi tatimor”, numer 277/5 prot date 03.12.2012, nxjerre nga Drejtoria Rajoanle e Tatimeve Shkoder.

Bazaligjore: Nenet 106 e 109 te ligji numer 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqipersie” i ndryshuar, udhezimi numer 24 date 02.09.2008 i Ministrise se Finanacve . Ligji numer 49/201232 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” .

Gjykata në seancën gjyqësore te dates 26.05.2015, pasi dëgjoi palën paditëse që deklaroi se heq dore nga gjykimi i padise dhe kerkoi pushimin e gjykimit, palën e paditur që kerkoi pushimin e gjykimit te çështjes, shqyrtoi dhe analizoi provat shkresore

VEREN SE

Pala paditëse “Kampion sh.p.k” , me seli ne Shkoder, i eshte drejtuar Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Shkodër me padi kunder Drejtorise Rajonale te Tatimeve Shkoder dhe Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane, me objekt:

“Shfuqizimin e aktit administrativ “Njoftim vlersimi tatimor”, numer 277/5 prot date 03.12.2012, nxjerre nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder”.

Gjykata ne ushtrim te funksioneve te saj kushtetuese dhe ligjit numer 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, fillimisht caktoi seancen pergatitore, duke pranuar kerkesen paleve per te kryer aktin e ekspertimit kontabel. Thirri ekspertin, i caktoi detyrat dhe i dha kohen e mafaftueshme ekspertit per te realizuar aktin.

Njekohesisht caktoi si date te ardheshme te seances pergatitore ku eksperti konatabel do paraqiste aktin e ekspertimit, daten 26.05.2015, ora 14.30.

Në seancën gjyqësore të datës 26.05.2015 pala paditese, me akt te shkruar e nenshkruar dhe te paraqitur para trupit gjykues deklaroi para gjykates se heqe dore nga gjykimi i padise ,pa paraqitur ndonje argument, por kerkoi pushimin e gjykimit te çeshtjes.

Trupi gjykues,bazuar ne nenin 39 pika 3 të ligjit 49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", ne te cilin parashikohet se gjykata vendos pushimin e gjykimit kur paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë dhe nenin 201, paragrafi i parë i K.Pr.Civile,ne te cilin parashikohet se:"Paditësi ne çdo fazë të gjykimit mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Në këtë rast gjykata vendos pushimin e gjykimit.Edhe neni 299, gërma "b" të K.Pr.Civile, është parashikuar si një nga rastet e pushimit të gjykimit kur paditësi heq dorë nga gjykimi i çështjes. Nisur nga sa sanksionohet në këto nene dhe nga sa rezultoi në gjykim, duke qënë se pala paditëse heq dorë nga gjykimi për shkak se mungon objekti i kërkesë padisë, gjykata çmon se çështja duhet pushuar.

PER KETO ARSYE

Gjykata,bazuar ne nenin 39/3 të Ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" dhe nenet 306-310 te K.Pr.Civile


VENDOSI

- Pushimin e gjykimit të çështjes.
- Shpenzimet gjyqësore sic janë bërë.
- Kundër vendimit lejohet ankim i vecantë brenda 5 ditëve nga e nesërmja e shpalljes në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.


-Shkodër me datë 26.05.2015

SEKRETARE SEANCE

Erona Lacej



GJYQTAR
Tonin STERKAJ



VERTETOHET SE VENDIMI KA MARRË FORMË TË PRERË

SOT ME DATË. 02.06.2015

KANCELARE

BLERTA NURJA

